

Projektligji për Byronë procedohet në Kuvend



Faqe 3

Gërvalla: Nga dita e parë po përgatitemi për betejën në Apel



Faqe 2

Vuçiqi njofton “shefin” për dorëheqje



Faqe 4

Rugova, 1994: Kosovarët shpërfillen nga të gjithë, por janë gjallë

Faqe 7-14



KOHA DITORE

Numri 10498

www.koha.net



KOMPENSIMI I VIKTIMAVE NË SPECIALE

Mbrojtja e viktimave e quan të korruptuar drejtësinë në Kosovë

Në rastin ndaj ish-udhëheqësve të UÇK-së kanë nisur parashtrimet për procedurat e kompensimit të viktimave pas shpalljes së tyre fajtorë për krime lufte. Mbrojtja e viktimave ka kërkuar që të mos referohen për padi civile në Kosovë me arsyetimin se sistemi i drejtësisë në vend është i korruptuar. Një pretendim të tillë e kanë kundërshtuar juristët kosovarë

Blendina Veliqi

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Mbrojtja e cila përfaqëson 155 viktima në rastin e Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit ka kërkuar që të mos referohen për padi civile në Kosovë sa i përket kompensimeve.

Këtë pretendim, mbrojtja e ka mbështetur, duke u thirrur në konstatimet e gjyqtarëve në rastin e Pjetër Shalës dhe Salih Mustafës, se gjoja sistemi i drejtësisë në Kosovë ka shumë mangësi dhe është i korruptuar.

“Mangësi të tjera përfshinin: ekzistencën e mundshme të një niveli të caktuar të korrupsionit dhe ndërhyrjeve brenda sistemit juridik të Kosovës dhe mungesën e strukturave efikase të llogaridhënies për gjyqësorin; kohëzgjatjen e procedurave civile”, ka pretenduar Simon Laws, mbrojtës i viktimave.

Ish-kryetari i Gjykatës Supreme, Fejzullah Hasani, ka thënë se deklaratat e tilla për sistemin e drejtësisë në Kosovë janë paragjyqese.

“Pretendimet se mund të ketë ndërhyrje i konsideroj paushalle dhe të motivuara nga qëllime dashakeqëse, por njëkohësisht edhe paragjyqese. Kjo për faktin

se, kur kemi të bëjmë me zhdëmtimin, çështja lidhet drejtpërdrejt me përgjegjësinë penale të të pandehurve...Në asnjë mënyrë nuk mund të shmanget referimi i çështjeve për kompensimin e viktimave në gjykatat e Kosovës, vetëm mbi bazën e paragjyqimeve se mund të ketë ndërhyrje eventuale”, ka thënë Hasani.

Avokati Ardian Bajraktari ka thënë se deklarata është e pabazuar, duke shtuar se përkundrazi DHSK-ja ka vepruar në shpërputhje me çdo parim të së drejtës ndërkombëtare.

“Vlerësoj që është deklarata e pabazuar dhe e natyrës tendencioze dhe si e tillë është absolutisht e papranueshme prej kujtdo qoftë, aq më tepër prej personave që me letra supozohet që janë pjesë e sistemit tonë të drejtësisë”, ka thënë Bajraktari.

Përveç pretendimeve për sistem të korruptuar të drejtësisë, mbrojtja e viktimave ka thënë se kuadri ligjor në Kosovë nuk e njuh ruajtjen e anonimitetit.

Por Fejzullahu ka deklaruar se trajtimi i këtyre padive civile bëhet me kriteret që aplikohen në Kosovë.

vijon në faqen e dytë



Tiranë, 26 shtator - Kombëtarja e Shqipërisë në futboll e ka nisur me fitore aventurën e re në Ligën e Kombeve. Shqipëria të dielën mbrëma në stadiumin “Air Albania” në Tiranë e mposhti Bjellorusinë me rezultatin 2:0, në kuadër të Grupit 1 të Ligës C. Golat u shënuan nga Kristjan Asllani e Ernest Muçi. Qe ndeshja e parë zyrtare e përzgjedhësit Rolando Maran

IDENTIFIKIMI I MBETJEVE MORTORE TË “GRUPIT TË INTELEKTUALËVE”

Familja Mëziu pret përgjigje për nëntë anëtarët e tjerë të zhdukur

Ardona Popova

SKENDERAJ, 26 SHTATOR - Pritjen prej 27 vjetësh për gjetjen e dhjetë familjarëve të zhdukur me dhunë gjatë luftës, Habib Mëziu nga Marina e Skenderajt e ka lehtësuar pjesërisht. Njëri prej 23 trupave, mbetjet mortore të të cilëve u gjetën në tri varreza masive në Zubin-Potok, është konfirmuar se i përket vëllait të tij, Salih Mëziu.

Por për të, lufta nuk ka marrë fund. Sepse ende pret të gjenden edhe trupat e dy vëllezërve të tjerë dhe shtatë kushërinjëve të tij, për të cilët që nga 19 prilli i vitit 1999 nuk ka pasur asnjë informacion.

Gjatë luftës Habibi nuk ndodhej në

Kosovë. Ai pati mbajtur vazhdimisht kontakt me vëllezërit dhe familjarët e tjerë, deri në ditën kur ata u zhdukën.

“Nga Terdec i Drenasit kanë kaluar në Abrinë e Drenasit. Tanaj në Arbrinë e Skenderajt dhe kështu kanë zbritë edhe në Ticë edhe në Llaushë të dajtë e mi e kanë pas edhe takimin e fundit ku kanë marrë udhëzime nga daja, i ndjerë tani, që ai u ka ofru atyre strehim dhe u ka thënë se ‘operoni këtu nëpër male kudo, por në mbrëmje ejani këtu’ dhe u ka thënë se ‘vendet që ju nuk i njihni për juve janë të rrezikshme’. Ata kanë vazhdu prej Llaushë kanë shku në Brabanicë dhe prej aty janë taku të gjithë me intelektualët e Mitrovicës

edhe kanë shku në drejtim të Radi-shevës. Aty pastaj janë pa për herë të fundit”, ka rrëfyer Habib Mëziu.

Familja Mëziu nuk e di se çfarë kanë përjetuar ata para se të vriteshin.

“Na e kemi ditë që kanë përfundu aty e ndjenjat e para janë ato që... një dhimbje e jashtëzakonshme se ne sot e asaj dite nuk e dimë çka kanë përjetu, na e dimë që janë pushkatu por nuk e dimë se si i kanë pushkatu, se si i kanë torturu, se çka kanë bo me ata njerëz, ne nuk e dimë”, ka thënë ai.

Dhjetë të zhdukurit nuk janë të vetmet viktima të luftës në familjen Mëziu.

Habibi ka rrëfyer edhe për të afërme

të tjerë të vrarë, mes tyre pleq e persona të pambrojtur.

“Axha im ka qenë mbi 90 vjeç, është vra brenda dy metrave, e ka pa pistoletën që ia kanë drejtu. Baba im ka qenë afër të 80-tave, axha tjetër 88 vjeç, axha ma i vogël ka qenë diku 70 vjeç. Tanë janë pushkatu qetu. Një grua e axhës, qatje e kemi pas një grumbull plehu, ja kanë dhanë një plumb në krye edhe e kanë lanë në pleh, sot e asaj dite nuk dihet ajo ku është. Një dajë të axhës që ai ka qenë edhe hendiKep e kanë mbyt me shkelma. A pushkatohet një plak 90 vjeç?” ka shtuar Habib Mëziu.

vijon në faqen e dytë

Kosova e motivuar, synon rezultat pozitiv në Vjenë



Motivimi pas fitores ndaj Irlandës është shumë i lartë te Kosova. Dhe momentin, “Dardanët” synojnë ta shfrytëzojnë edhe të dielën në ndeshjen e vështirë ndaj Austrisë nga ora 18:00 në “Ernst Happel” të Vjenës. Ndeshja Austria – Kosova është e dyta e edicionit të pestë të Ligës së Kombeve. Austria është favorite absolute...

Faqe 14